



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA Durrës**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**KOMISIONI I BUXHETIT, FINANCËS DHE TAKSAVE-TARIFAVE**

Datë 22.12.2025

**RAPORT VENDIMMARRJEJE**

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE ME VLERË TOTALE 50'572'489 (PESËDHJETË MILIONË E PESËQIND E SHTATËDHJETË E DY MIJË E KATËRQIND E TETËDHJETË E NËNTË LEKË), PËR LIKUIDIMIN E PLOTË TË DISA FAMILJEVE DHE PËR LIKUIDIMIN ME KËST TË PJESËS TJETËR, TË DËMTUARA NGA PËRMBYTJET E SHKAKTUARA NGA RESHJET INTENSIVE TË SHIUT TË DATAVE 29.01.2025 – 30.01.2025**

**Baza ligjore:**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligji nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Financave me nr. 492/1 prot, datë 25.02.2025 me kodin e produktit: "*Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme*" - kodi i produktit 91707AB,

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër** *(Çfarë propozohet në projektvendim)*:

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Sherbimeve Publike, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë totale 50'572'489 (pesëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025 – 30.01.2025, e ndarë si më poshtë:
  - a) Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë 6'592'545 (gjashtë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e dyzet e pesë) lekë për 89 familje, që

do të likujdohen plotësisht, për të cilat vlera e dëmit të konstatuar është më e ulët se shuma e kësti për familjet që do të trajtohen me ndihmë financiar e ndarë në këste, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur.

- b) Miratimin e dhënies së ndihmës financiare me vlerë 43'979'944 (dyzet e tremilionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekë për 342 familje, të cilat do të trajtohen me këste, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur.

2. Dhënia e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025 – 30.01.2025 do të përballohet nga:

- a) Fondi me vlerë 37'572'489 (tridhjetë e shtatë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë, e cila do të merret nga fondi i papërdorur, i alokuar nga Ministria e Financës më shkresën me nr. 492/1 prot, datë 25.02.2025 me kodin e produktit 91707AB, *“Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme”*.
- b) Diferenca prej 13'000'000 (trembëdhjetë milionë) lekë do të merret nga buxheti i Bashkisë Durrës, i dedikuar për programin “Emergjencat Civile”, e cila vihet në dispozicion për përballimin e këtij procesi, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

Fonde të papërdorura, alokuar nga Ministria e Financës dhe nga buxheti i bashkisë Durrës.

**Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Drejtoria e Shërbimeve Publike.

**Impakti social/grupet që preken:**

Banorë të bashkisë Durrës të dëmtuara nga përmbytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025 – 30.01.2025

**A është objekt konsultimi: (PO/JO)**

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mbledhë më datë 22.12.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 4 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetari hapë mbledhjen dhe pyeti për miratimin e kësaj pyetje nga anëtarët e komisionit prezert.  
Nga komisioni: nuk ka pyetje dhe votuan unanimitet për kalimin e kësaj pike në ~~si~~ Këshillin Bashkiak.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- \_\_\_\_\_

**Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave**

Kryetar

Rolant Xhelilaj

Zv/Kryetar

Erzen Laçi

Sekretar

Hekuran Markola

Anëtar

Jonada Mamo

Anëtar

Alfred Mullaraj

Anëtar

Denisa Luarasi

Anëtar

Silvana Agasi

Anëtar

Dritan Burgija

Anëtar

Jonuz Myshketa

Anëtar

Xhojana Gjineci

Anëtar

Kontjana Kuçi